



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
-AUTORITETI I KONKURENCËS-

**Njoftim paraprak për përqëndrimin BFSE Holding BV & SIFEM—
CREDINS Bank ShA**

Në datën 27 Nëntor 2007, Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e përqëndrimit të propozuar¹ sipas së cilit shoqëritë Balkan Financial Equity Fund (BFSE Holding BV) me seli në Amsterdam, Hollandë dhe Swiss Investment Fund for Emerging Market (SIFEM), me seli në Bernë, Svicër, përftojnë kontroll nga blerja në total të 25.4% të aksioneve të Bankës Credins Sh.A, respektivisht 22.2% dhe 3.2%.

1. Ky transaksion, sipas marrëveshjes së investimit, nënshkruar nga palët pjesëmarrëse është kryer në datën 14 Nëntor 2007.

2. Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse është:

- Për Balkan Financial Sector Equity Fund (BFSE Holding BV): pjesëmarrje në veprimtari financiare dhe manaxhim ndërmarrjesh të tjera;
- Për Swiss Investment Fund for Emerging Market: financim dhe administrim i portofolit të investimeve në vendet në zhvillim dhe në tranzicion, në emër të Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike të qeverisë svicerane;
- Për Bankën Credins ShA: Kryerja e veprimtarisë bankare dhe financiare në tregun e brendshëm;

3. Nga shqyrtimi paraprak, Autoriteti gjeti, që transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit dhe do t'i nënshtrohet procedurës së kontrollit të përqendrimeve të përcaktuar në nenin 56 të Ligjit dhe në Rregulloren “Për Zbatimin e Procedurave të Përqendrimit të Ndërmarrjeve”.

4. Autoriteti fton palët e treta për të shprehur opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr 0355 4 234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati 4, Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al

¹ Në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja b të Ligjit Nr.9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës”